



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:073655
Datë: 05.06.2024
Numri i dokumentit: 05783857

Cap.nr.1556/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga gjyqtarja individuale Naime Ahmeti, në çështjen përbarimore të kreditorit “S.” sh.p.k, me seli në Prishtinë, Lagja M. 1, e përfaqësuar sipas autorizimit nga shoqëria e avokatëve “Sh. & A.”, kundër debitorit K.H. nga Prishtinë, i përfaqësuar sipas autorizimit nga B.D., avokat në Prishtinë, me bazë juridike përbarimore-borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.372/22 të datës 07.08.2023, me datë 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të debitorit K.H. nga Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.372/22 i datës 07.08.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.372/22 të datës 07.08.2023, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përbarimit K.H. nga Prishtina të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.D. avokat në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrit mbi caktimin e përbarimit P.nr.96/2022 të datës 28.03.2022, të nxjerr nga organi përbarues-përbaruesi privat Eset Murati.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i debitorit, për shkak shkeljes së dispozitave të procedurës përbarimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovet ankesa e debitorit, të anulohet aktvendimi i

atakuar PPP.nr.372/22, dhe të detyrohet gjykata e shkallës së parë të vendos sipas prapësimit për përmbarim.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, ashtu që në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbarues para kontratës për shitblerjen e patundshmërisë LRP.nr...., numër referencës 0296/2016 të datës 14.06.2016, ku kreditori i ka shitur banesë debitorit në shumë prej 62,057 euro, prej të cilës shumë pjesa ka mbetur pa u paguar vlera prej 13,119.00 euro. Përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin e kërkuar me urdhrin P.nr.96/22 të datës 28.03.2022, ndaj këtij urdhri, debitori ka paraqitur prapësim me datën 06.04.2022, ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit me datën 07.04.2022. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Kjo Gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par.2 të LPK-së, për arsye se është i kuptueshëm, i qartë dhe se përmban arsye të mjaftueshme bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata përmbarimore drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale aplikimin e drejtë të së cilës gjykata e shkallës së dytë e heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Organi përmbarues e cakton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues dhe dokumentit të besueshëm, siç e përcakton dispozita e nenit 21 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për ekzekutim në bazë të dokumentit përmbarues të paraparë me dispozitën e nenit 22 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore. Dokument përmbarues, sipas nenit 22, paragrafi 1 nënpar.1.3 të LPP-së, si dokument përmbarues, është edhe *dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë*, ndërsa sipas nenit 26 par.1 i LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i noterizuar është i përmbarueshëm nëse është bërë i përmbarueshëm sipas rregullave të veçanta që rregullojnë përmbarueshmërin e atij dokumenti”*. Në kuptim të dispozitave të cituara më lart, e pas vlerësimit të para kontratës për shitblerjen e patundshmërisë LRP.nr...., numër referencës 0296/2016 të datës 14.06.2016, u gjet se e njëjta e përmbushë formën e paraparë me shkrim, përmban të dhënat e nevojshme lidhur me palët, qëllimin dhe objektin e kontratës, të drejtat dhe detyrimet e secilës nga palët e kësaj para kontrate mënyrën e kompensimit, afatet si dhe kushtet tjera të parapara nga palët kontraktuese, e njëjta përmban vullnetin e lirë dhe të plotë të palëve, nënshkrimin nga ana e noterit, dhe është

bashkangjitur në kopje të vërtetuar siç përcakton dispozita e nenit 36 par.1 të LPP-së, andaj si e tillë kjo para kontratë i përmbushë kushtet për të qenë dokument përbarimor konform dispozitave ligjore në fuqi.

Nuk qëndron pretendimi ankimor se sipas pranimit teknik kemi ndryshim të m2 dhe se duhet ndryshuar edhe para kontrata. Gjykata e Apelit gjen se sipas shkresave të lëndës përkatësisht email-it të datës 12.11.2022, debitori ka shumën e borxhit paraprak në vlerë prej 13,119 euro, për të cilën shumë është inicuar procedura përbarimore, ndërsa sipas të dhënave nga Komuna banesa ka shtim prej 3.3 m2, dhe se shuma për pagesë është prej 2871 (870 euro, m2), dhe sipas ligjeve në fuqi, para kontrata është kontratë me të cilën merret përsipër detyrimi që më vonë të lidhet kontrata tjetër kryesore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Cap.nr.1556/2023 me datë 05.06.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti